

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

NR / ZA / TO	<i>Ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural</i> Nenad Rikalo	DATE DATUM DATE	24 Maj 2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Naser Rugova, Deputet i Grupit Parlamentar të LDK-së</i> 		
SUBJEKTI FREDMET SUBJECT	<i>Pyetje Parlamentare</i>		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja:


Kohëve të fundit në disa treva të Republikës së Kosovës ka pasur të reshura breshëri të cilat në masë të konsiderueshme kanë dëmtuar shumë kultura bujqësore.

Pyetja:

A keni të dhëna të sakta për shumën totale të dëmeve të shkaktuara dhe cilat janë masat e ndërmarra nga ministria që ju e drejtoni në kompensimin e dëmeve të shkaktuara për agroprodhuesit e prekur nga këto fatkeqësi elementare?



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly



KORAB R. SEJDIU

Deputet
Poslanik – Representative

Për / Za / For:	Z. Bajram Hasani, Ministër Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Nga / Od / From:	Korab R. Sejdiu, Deputet
Data / Datum / Date:	14 qershor 2018
Referenca / Referenca / Reference:	06/2018
Lënda / Predment / Subject:	Pyetje parlamentare

Në bazë të Nenit 45 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, shtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në seancën e rradhës.


Çështja: Kohë më parë, në kuadër të veprimeve që MTI ka ndërmarrë për të përmirësuar ambientin e biznesit në Kosovë si dhe reformat e nevojshme për rangim më të lartë në “doing business index” të Bankës Botërore, MTI ka hartuar kornizën ligjore që ua ndalon qeverive lokale, përkatësisht komunave, të drejtën për të imponuar taksa apo tarifa për shoqëritë tregtare për ndërmarrjen e veprimtarisë afariste. Mirëpo, kemi pranuar ankesa nga bizneset që veprojnë në Komunën e Graçanicës, të cilat na njoftojnë se Komuna e Graçanicës ka filluar me imponimin e taksave për veprimtari afariste për këto biznese që veprojnë në këtë Komunë.

PYETJA: Z. Ministër, çfarë hapa urgjent do të ndërmerrni si ministër i MTI, por edhe në koordinim me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, për të ndërprerë këtë praktikë të jashtëligjshme dhe shumë të dëmshme për bizneset nga Komuna e Graçanicës por edhe për reputacionin e Kosovës si vend që po synon joshjen e investimeve të huaja.



REPUBLIC OF KOSOVO
 REPUBLIKA E KOSOVES
 SKUPSTINA REPUBLIC OF KOSOVO
 ANSTETI E REPUBLIC OF KOSOVO
 Zyra per Propozime dhe Turunizero, Afta, 10 Pristine, Prishtine, Tabe 02100
 Nr. i Propozimit: 06/1659/06-929
 Data: 02.07.2018
 PRISTINE - PRISTINA - PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Pal Lekaj – Ministër i Infrastrukturës	DATE DATUM DATE	02.07.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Salih Zyba, deputet i Lëvizjes VETËVENDOSJE! 		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.


ÇËSHTJA: Dëmshpërblimi për qytetarët e dëmtuar nga “Bechtel Enka”

Qytetarët në Komunën e Kaçanikut, konkretisht të fshatit Kukaj, tash e sa kohë po përballen me vështirësi të mëdha të shkaktuara nga kontraktori Bechtel Enka. Ky region ishte përfshirë nga vërshime të mëdha të shkaktuara nga dëmtuesi, qytetarët e këtij rajoni po kërkojnë kompensim për dëmin që ju është bërë. Së fundmi sipas një lajmi në media është vlerësuar se ky dëm kap vlerën prej 80 mijë deri në 100 mijë euro.

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar Ministër,

A janë dëmshpërblyer qytetarët e Kaçanikut, dhe nëse po nga kush? Nëse jo, përse nuk janë dëmshpërblyer?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PËR / ZA / TO	z. Abelard Tahiri, Ministër i Drejtësisë	DATE DATUM DATE	03.07.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	Albulena Haxhiu, deputete e Lëvizjes VETËVENDOSJE!		
SUBJEKTI FREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare (përgjigje me gojë)		

Në bazë të Rregullës 45 e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

ÇËSHTJA

Fusha e së Drejtës Ndërkombëtare Private në Kosovë është e rregulluar me *“Ligjin për Zgjidhjen e Kolizionit të Ligjeve me Dispozitat e Vendeve tjera në Marrëdhënie të Caktuara të ish RSFJ-së nr. 43/82 dhe 78/822”*.

Ligji i cili zgjidh kontestet juridiko-private me element të huaj është në fuqi që nga 1 janari i vitit 1983. Ky ligj për shkak të rrethanave të ndryshuara politike, juridike, ekonomike në Republikën e Kosovës nuk ka gjetur zbatim funksional në praktik.

PYETJE PARLAMENTARE

I nderuar, Ministër

Pse ende nuk është nxjerrë ligji i ri i cili rregullon fushën e së drejtës ndërkombëtare private, kur dihet fare mirë që për shkak të rrethanave të ndryshuara politike, juridike dhe ekonomike edhe shtetet që kanë dal nga sistemi politiko-juridik i ish Jugosllavisë, kanë nxjerrë ligjin e ri me të cilin kanë rregulluar këtë fushë mjaft më rëndësi për qytetarët në përgjithësi?